

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

MBLEDHJA XXX

“Nga Pagat e Ulëta tek Produktiviteti në Punë”

Tiranë, 18 prill 2023, 11:30 – 14:15

Mbledhja u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI. Në mbledhje morën pjesë 13 anëtarë të KI dhe rreth 20 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

Hapja e Mbledhjes nga Ministria Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI

Në fjalën e saj hyrëse, Ministria Ibrahimaj shpjegoi se kjo është një mbledhje jashtë kalendarit të KI dhe zhvillohet në kuadër të dialogut që qeveria ka nisur me sipërmarrjen për nevojën e rritjes së pagave. Qeveria ka vendosur të rrisë pagën minimale në 40,000 lekë nga 1 prilli 2023. Këshilli i Investimeve ka kryer një anketë ku janë anketuar 506 biznese mbi ndikimin e rritjes së pagave të ulëta në produktivitetin dhe konkurrencën në treg. Ministria theksoi se rezultatet e anketës tregojnë se biznesi mbështet rritjen e pagës minimale dhe mesatare në vend. Rreth 50% e bizneseve të anketuara vlerësojnë se rritja e pagës minimale ishte e nevojshme dhe mbështesin rritjen e mëtejshme të pagës minimale, kryesisht në shërbime, tregti dhe turizëm. Qeveria synon të rrisë pagën mesatare në vend përmes masave të ndryshme, duke përfshirë rishikimin dhe rritjen e pagave të nëpunësve publikë. Qëllimi është të sigurohet stabiliteti në të ardhmen dhe që rritja e pagave të mos jetë e paplanifikuar ose e menduar keq, por një proces i vazhdueshëm.

Prezantimi i analizës së Sekretariatit

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, informoi se analiza e Sekretariatit ka si qëllim kryesor: i) evidentimin e perceptimeve të sipërmarrësve lokalë ndaj impaktit të rritjes së pagës minimale dhe perspektivës për një rritje të mëtejshme, dhe b) stimulimit të debatit se si bizneset shqiptare (veçanërisht NVM-të) të bëhen më konkurruese duke u fokusuar në investimet për rritjen e produktivitetit dhe motivimit të fuqisë punëtore. Nëpërmjet këtij studimi, Sekretariati parashtron për miratim katër rekomandime:

1. Nëse konsiderohet hartimi i një plani kombëtar për pagat, atëherë *qeveria në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit të inkurajojnë përfshirjen e publikut dhe ta konsiderojnë atë si një instrument për të konsultuar çështjet e produktivitetit të punës dhe pagat* duke përfshirë gjithashtu punonjësit dhe sindikatat e tyre në diskutime të fokusuar.
2. *Prioritizimi i përpjekjeve dhe ndërhyrjeve për të përmirësuar kulturën e punës dhe për të ofruar punësim të denjë për të gjithë* përmes edukimit të punonjësve dhe punëdhënësve për legjislacionin e punës dhe kontratat e punës - të drejtat dhe detyrimet.
3. Qeveria në bashkëpunim me partnerët socialë të përfshihet në një proces gjithëpërfshirës të ndërtimit të konsensusit për të vlerësuar *miratimin e një mekanizmi të indeksimit të pagave si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat në baza vjetore*.
4. Për të trajtuar këto çështje të ndërthurura, *të lehtësohet pagesa e kontributeve proporcionale shoqërore dhe shëndetësore për punësimin me kohë të pjesshme*, duke avokuar për pagë pune/orë (për diskutime të mëtejshme).

Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Ministria Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se disa nga pikat e rekomandimeve janë duke u konsiduar nga qeveria për t'u implementuar në bazën ligjore. Më specifikisht:

- i) Indeksimi i pagave për administratën publike një herë në dy vite sipas normës mesatare të inflacionit për të ofruar një qëndrueshmëri të kësaj politike në të ardhmen. Ky proces do të fillojë të jetë i zbatueshëm që në përfundimin e reformës së pagave, d.m.th. pasi të përfundojë rritja e rrogave në korrik të 2024.
- ii) Krijimi i një ligji që do të krijojë paketa të tjera për mbajtjen dhe motivimin e stafit të administratës publike. Ka ardhur momenti që bizneset e mëdha të kenë një politikë të burimeve njerëzore dhe të rritjes së tyre, përveç politikave që ofrojnë ato individualisht.

Në lidhje me rekomandimin e parë, Ministria informoj se në kuadër të planit kombëtar të pagave, rritja do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, me qëllim arritjen e nivelin 45,000 Lekë në vitin 2025. Ky është një nivel i përballueshëm i cili e bën Shqipërinë në nivele konkurruese përsa i përket kostos së prodhimit. Pra kjo nuk do të jetë një politikë që do të njoftohet çdo vit, por do të jetë një plan i mirëmenduar të paktën për tre vitet në vijim.

Z. Arben Shkodra, Shoqata e Prodhuesve, theksoi rëndësinë e të patuar fillimisht të një pakete apo plan veprimi kombëtar për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, dhe më pas t'i takonte të gjitha grupeve të interesit, operatorëve ekonomikë që të fillonin dhe të reflektonin mbi rritjen e pagave, në vend që ushtrohej një presion tek sektori privat nëpërmjet indeksimit të pagave në sektorin publik. Fatkeqësisht kjo gjë ka ndodhur.

Nëse flitet për produktivitetin, të paktën të realizohen tre elementë:

- i) Disponueshmëria e fuqisë punëtore është një problem madhor. Sektori i prodhuesve nuk ka asnjë ndikim nga rritja e pagës minimale për arsye se prej 4 vitesh ky nivel është kaluar tashmë (përfshirë pagën minimale dhe atë mesatare). Struktura aktuale e ndërmarrjeve në vend është 99.8% biznese të vogla, mikro, individë. Në këtë strukturë, duhej të kishte më shumë prodhues dhe ofrues shërbimesh.
- ii) Aftësimi i punonjësve për të merituar pagën që pretendohet t'iu jepet. Probleme hasen në ardhjen e fuqisë punëtore të paaftësuar dhe të pakualifikuar. Arsimi profesional është problematik pasi punonjësit e rinj nuk vijnë mjaftueshëm të kualifikuar, por me pretendimin që e duan atë pagë.
- iii) Shqipëria është futur në qarkullimin global të punonjësve. Punonjësit e huaj që vijnë në vend rrinë për 5 ditë.

Produktiviteti përballlet me strukturën e kostos. Në strukturën aktuale të kostos përfshihen pagat, ku në sektorin fason zënë zërin kryesor. Sistemi fiskal aktual nuk është i favorshëm dhe ndikon konkurrueshmërinë e sektorëve të caktuar të prodhimit, si ajo e përpunimit të mishit. Një tjetër faktor është precipitimi i kursit të lekut me euron. Modernizimi bëhet i pamundur kur mungon aksesimi në financë, ashtu siç kërkohet dhe ekziston për partnerët e prodhimit në Evropë dhe Ballkan. Për tranzicionin dixhital nevojiten para nga bankat që nuk japin, nga fondet që nuk aksesohen dot.

Z. Zak Topuzi, Shoqata e Turizmit/Hotel Mondial, shprehu mbështetjen për nismën e qeverisë për rritjen e rrogës minimale, duke u shprehur që sektori i hotelierisë e ka tejkaluar prej kohësh këtë nivel, duke ofruar edhe shpërblime të mëdha për punonjësit për t'i mbajtur ata.

Probleme kryesore për industrinë turistike të cilët prekin gjithashtu edhe pagat janë:

- i) Formalizimi i tregut. Sipas një studimi të kryer nga PNUD, rreth 47% e industrisë së turizmit është informale, kryesisht apartamente dhe vila. Kërkohet ndihma e qeverisë për të zgjidhur këtë çështje. Një industri e formalizuar paguan minimalisht 30% më shumë për pagat, pa përfshirë dhjetëra kontrole dhe certifikime të cilat detyrohet t'i paguajë një biznes

që është i certifikuar. Nga www.booking.com është komunikuar që Shqipëria është vendi i fundit që nuk ka një kërkesë zyrtare për bllokimin e operatorëve të cilët nuk kanë një NIPT aktiv. Kjo duhet të bëhet nga MFE.

- ii) Kartat e kreditit. Bizneset nuk kanë interes t'i përdorin për shkak të kostos së lartë. Sipas sektorit bankar, interesi i lartë i përdorimit është vendosur nga dy operatorët kryesorë (Visa dhe MasterCard) të cilat e quajnë Shqipërinë vend të pasigurtë.
- iii) Në sistemin fiskal të suportohet sistemi TIPS duke e raportuar veçmas , pasi të gjithë të turistët e huaj preferojnë të paguajnë me kartë. Në rast se sistemi TIPS do të futej në sistemin fiskal, ai do të hynte në xhiron e biznesit, gjë e cila do të shoqërohej edhe me pagesën e tatimit.

Ministria Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se mund të organizohet një takim javën e ardhshme vetëm me përfaqësues të turizmit dhe të vendoset një plan pune i përbashkët për çfarë sugjerohet nga biznesi i sektorit. Çështja e pagave në sektorin e turizmit lidhet kryesisht me formalizimin.

Znj. Elisabeta Katiaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, vlerësoi iniciativën e rritjes së pagës minimale, dhe parashtrori sugjerimet e mëposhtme:

- Rritja e pagave të mos jetë me nivele dhe me periudha sporadike. Ndryshimet të bëhen për të paktën një periudhe 2-vjeçare, në mënyrë që ndryshimet e pagës minimale për kontributet të mos bëhen në periudha të shkurtra kohore.
- Sektori privat ka nevojë të edukojë punëmarrësit duke qënë se kontratat nënshkruhen me pagë neto dhe nuk ka një njohje të punëmarrësit në lidhje me pagën bruto/neto për të kuptuar edhe ato që punëdhënësi paguan për të. Ky edukim do të ndihmojë gjërësisht edhe në formalizim.
- Digjitalizimi dhe inovacioni janë shumë të rëndësishme për sektorin privat dhe duhet të arrihet kanalizimi i fondeve në këtë drejtim.
- Vendosja e një limiti të pataksueshëm për të ardhurat që preken nga tatimi në burim, ashtu sikundër ekziston edhe në vende të tjera (Gjermania p.sh. ka një limit 5.000 euro të pataksuar për individin).
- Ngritja e një grupi punë për shqyrtimin e këtyre propozimeve, ku theks t'i vihet edhe trajtimin të dietave dhe shpërblimeve, të cilat janë tashmë të vjetra si nocione dhe trajtimi fiskal duhet të rregullohet për të patur trajtimin e duhur fiskal.

Pra, theksi të vendoset tek digjitalizimi i proceseve dhe shoqërimi i rritjes së pagës minimale edhe me rregullimet e duhura procedurale. Rritja e pagës minimale nuk sjell rritje të kostove për biznesin, por ndryshimi i shpeshtë i saj krijon shpërqëndrim për sektorin privat në vend. Rritja e pagës minimale nuk sjell rritje të kostove për biznesin, pasi nëse punëmarrësit informohen në lidhje me pagën bruto dhe neto ata do të jenë më të qartë dhe më pranues në lidhje me pagën dhe përfitimet e tyre.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, u shpreh se rekomandimet e dhëna nga Sekretariati janë edhe rekomandimet Dhomës së Tiranës. Rekomandimet e dhëna duhet të ndiqen për të hartuar edhe paketën e ndërhyrjeve. DHTI TR ka patur mundësi të marrë pjesë në debatin për rritjen e pagës minimale dhe mbështet rritjen e pagës minimal. Ajo duhet të jetë konkurruese, madje më lart se e rajonit.

Aktualisht, vendi vuan nga mungesa e fuqisë punëtore në sasi, por akoma më tepër për punonjës të kualifikuar, gjë e cila sjell produktivitet të ulët. Pra gjen punonjës të diplomuar, por jo kompetent për punën. Pagat në shumë kompani në vend për inxhinierë dhe drejtues prodhimi të aftë në punën e tyre janë edhe më të larta se në vendet e rajonit.

Produktiviteti të shihet në dy shtylla: Produktiviteti i kapitalit human dhe produktiviteti i ndërmarrjeve mikro të vogla, të mesme dhe të mëdha. Shqipëria përveçse se është deficietare në teknologji, vuan edhe nga mungesa e një pakete ndihmëse financiare nga ana e qeverisë në këtë drejtim. Në Shqipëri ende mungon profili i prodhuesit shqiptar dhe cilët janë sektorët që duhet të performojnë në prodhimin shqiptar.

Arsyeja që ne sot nuk jemi konkurrues në rajon është e lidhur direkt me mungesën e teknologjisë së duhur. Një ekonomi sot konkurren me sasi prodhimi dhe me cilësi (teknologji). Në jemi prapa në të dyja si në sasi ashtu edhe në cilësi. Sot në Shqipëri ka ikur koha kur duhet të nënshkruhen kontrata bazuar në vlerësimin e ulët të kapitalit human. Kanë hequr dorë vende me numër të madh popullsie si Kina e India, jo më vendi ynë me afro 1 mln kapital human. Me anë të paketave fiskale/subvencionuese të mund të ndihmohet sektori fason derisa të marrë veten.

Ndërkohë paga minimale 40.000 lekë është shumë e ulët. Minimalisht duhet të jetë 50.000 lekë dhe sigurisht nevojitet edukimi i punëmarrësit sepse kur promovohet paga 50.000 lekë ata mendojnë se do të marrin në dorë 50.000 lekë.

Çështje tjetër për t'u patur parasysh është edhe informaliteti. Të paktën tek industria me origjinë shtazore, gati 90% e tyre janë informale. I gjithë ky informalitet nënkupton detyrime të tëra fiskale të papaguara dhe ul produktivitetin tek kompanitë formale. Prandaj edhe edukimi i punëmarrësve merr vlerë pasi ata duhet ta kuptojnë që nuk mund të punojnë pa paguar sigurime shoqërore sepse kjo rrezikon të ardhmen e tyre dhe kjo është shumë e rëndësishme të injektohet siç duhet.

Në lidhje me mbështetjen nga ana e qeverisë, për pjesën e sigurimeve shoqërore, shpreh dakordësinë përse i përket fazonëve.

Ndërkohë duhet një disiplinim për indeksimin vjetor të pagave me inflacionin ashtu sikundër edhe ndodh rritja e çmimeve. Nga ana tjetër duhet të disiplinohet edhe administrata shtetërore për indeksim me inflacion edhe të kontratave që ajo ka me sipërmarrjen. Përse i përket rritjes së pagave në administratë shprehet dakort por duhet që kjo të shoqërohet me efikasitet dhe produktivitet të punonjësve të administratës dhe të çojë në minimizim maksimal të korrupsionit në mënyrë që ata t'i shërbejnë ligjit dhe vetëm ligjit.

Z. Neritan Mullaj, Amcham, vlerësoi bashkëpunimin me Sekretariatit mbi këtë temë.

Së pari, ky debat mbi pagën minimale duhet të niste para se të merrej vendimi, duke qenë se tani jemi para një fakti.

Së dyti, rritja e pagës minimale automatikisht sjell rritje të pagës maksimale dhe kjo direkt përkthehet në rritje kostosh për biznesin.

Informaliteti gjithashtu duhet të luftohet pasi ne e dimë që shpesh bëhen pagesat në banke e më pas kthehen lekët nga punëmarrësit.

Në lidhje me produktivitetin, rritja e pagës minimale i kënaq punonjësit por nuk i motivon ata. Në fakt në këtë drejtim duhet të luajë rol edhe vetë biznesi duke u ofruar punëmarrësve punë të denjë. Ky studim i Sekretariatit është një pikë fillimi që duhet të thellohet. E rëndësishme është që vetë biznesi të mendojë të kalojë drejt rritjes së vlerës së shtuar duke filluar nga fazonët. Ndërkohë sot po ndryshon trendi i të bërit biznes dhe dalëngadalë do të kalojmë drejt një sipërmarrje që do të shfrytëzojë aftësitë e punëmarrësit dhe ata duhet të orientohen në këtë drejtim. Së fundmi, duhet edhe përshtatja e legjislacionit edhe për punët e reja të cilat janë tashmë në treg, si p.sh. profesionist i lirë (freelancer), etj.

Znj. Antoneta Hako, Dhoma Ekonomike e Gruas, u shpreh se biznesi i fiskalizuar e përkrah rritjen e pagës minimal dhe këtë prag e ka kaluar me kohë. Është e rëndësishme që kjo rritje page të mos përkthehet në rritje çmimesh. Nevojitet të adresohen disa çështje që kanë të bëjnë me

taksimim duke qënë se ato pengojnë konkurrueshmërinë e prodhimit vendas. Rritja e produktivitetit do të ndihmojë edhe konkurrueshmërinë e vendit në rajon. Problem ngelet edhe çështja e fuqisë punëtore të pa-arsimuar, problem që është theksuar tashmë në shumë tryeza dhe duhet ngritja e nivelit të shkollave profesionale. Informaliteti nga ana tjetër ndikon shumë në ekonominë tonë dhe duhet të ndërjegjësohemi sesa i aftë është sistemi ynë që këtë rritje page minimale ta gjurmojë tek të gjitha hallkat, që nga biznesi mikro e deri tek biznesi i madh. Konkurrueshmëria jonë preket edhe nga biznesi informal që është shumë i përhapur në vend dhe ndikon shumë sektorin e prodhimit, i cili jo vetëm ka kosto më të ulët, por edhe vepron në mënyrë të pakontrolluar. Gjithashtu bizneset që drejtohen nga gratë, rreth 30% e totalit, duhet të mbështeten më shumë në lidhje me aksesin në financim, temë e cila mund të diskutohet edhe në tryeza të tjera.

Z. Bledar Mankollari, DIHA, u shpreh se studimi është një bazë e mirë për ndryshimin tjetër të pagës minimale, pasi tashmë rritja e saj është një fakt dhe ky takim duhej të ishte bërë më parë. Ky forum është bazë e mirë për rritjen e pagës minimale, por rritja e produktivitetit do kohë dhe nuk ndodh brenda një viti. Në lidhje me pagën minimale, nevojitet të ndahen dy momente: së pari, kur rritja e saj bëhet për arsye të mbledhjes së të ardhurave për buxhetin e shtetit, dhe së dyti, rritja e koston së biznesit. Cili ka qenë qëllimi? Nëse nuk ka qenë qëllimi, rritja e të ardhurave të buxhetit, do të ishte mirë që rritja e pagës minimale të mos shoqërohet me rritje të sigurimeve për biznesin.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se qeveria e ka marrë parasysh këtë dhe prandaj ka marrë vendim që për ato biznese që kanë ndjeshmëri më të madhe nga paga minimale, pra ato që kanë mbi 70% të kostove të tyre kosto personeli, t'i subvencionohet pjesa e koston për sigurimet shoqërore. Qëllimi i rritjes së pagës minimale nuk është rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit por, i) rritja e produktivitetit, ii) shlyesa për të çuar në rritje të pagave në tërësi, iii) reduktimi i informalitetit.

Për sqarim, për rritjen e pagës minimale janë bërë shumë takime me sipërmarrjen në forume të tjera, përveç KI dhe takimi i kësaj dite nuk bëhet për rritjen e pagës minimale pasi trajektorja e pagës minimale tashmë është vendosur 40.000, 43.000 dhe 45.000. Tavorina sot është për të gjetur mënyra sesi do të punohet së bashku për të adresuar çështjet e tjera që lidhen me rritjen e pagës mesatare, rritjen e efijencës, produktivitetit, aksesit në financim apo edhe paketat ndihmëse nga ana e qeverisë për t'i adresuar më së miri këto problematika.

Znj. Elisabeta Katiaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, kërkoi ndihmën e qeverisë në lidhje me fiskalizimin e pagave, d.m.th. sistemi CATS të lejojë llogaritjen e pagës bruto dhe neto. Sistemi t'i lejojë biznesit të ngarkojë dokumentin e pagave nga excel direkt në sistem, duke qënë se pagat marrin një kohë të madhe të punës së financës.

Z. Arben Shkodra, Shoqata e Prodhuësve, theksoi se ka një keqkuptim midis punëdhënësit dhe punëmarrësit përse i përket pagës bruto dhe pagës neto dhe mendon se këtu qëndron problemi. Punonjësi kur vjen kërkon të dijë pagën neto dhe kontrata verbale bëhen bazuar në pagën neto. Është e drejtë të kërkohet nga të gjithë punëdhënësit lëshimi i një letre ku t'i tregohet punëmarrësit të gjithë përfitimet e tij dhe jo vetëm paga neto. A mundet të bëhet diçka në këtë drejtim duke detyruar financën e çdo biznesi të përgatisë këtë informacion për punonjësit. Ka kompani që e bëjnë, por kjo duhet të jetë masive dhe të kthehet në detyrim për punëdhënësin. Ky është një instrument që do të ndikojë edhe kulturën e punës.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, shprehu vlerësimin e saj për diskutimet e hapura dhe konstruktive që po zhvillohen në këtë tryezë, të mbështetur nga BERZH dhe SECO. Në lidhje me temën e diskutimit, znj. Solovova theksoi rëndësinë e politikave që nxisin konkurrencën afatgjatë të Shqipërisë edhe në kuadër të tregut të BE-së. Ndërsa pranoi rritjen e pashmangshme të pagave për shkak të inflacionit, znj. Solovova përmendi sfidat me të cilat përballen eksportuesit në kalimin

e kostos së rritjes të papritur tek blerësit ndërkohë që kontratat i kanë të paracaktuara prej 1 viti, duke theksuar rëndësinë e parashikueshmërisë. Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e mbështetjes së aktiviteteve me vlerë të shtuar brenda vendit, duke njohur kontributin me vlerë të IHD-ve në drejtim të rritjes së konkurrencës, njohurive dhe ekspertizës së NVM-ve shqiptare dhe ngriti pikëpyetje nëse ekzistojnë politika të mjaftueshme për të mbështetur biznese të tilla. Gjithashtu, znj. Solovova theksoi ndikimin negativ të dixhitalizimit të ulët të pagesave për bizneset e vogla dhe avokoi për rritjen e aksesit në financë dhe aftësi punëtore për të përmirësuar konkurrencën e sektorit privat. Ajo theksoi mbështetjen e BERZH-it përmes programeve dhe asistencës teknike, të cilat synon rritjen e produktivitetit dhe mbështetjen e NVM-ve për të aksesuar financim dhe aftësi punëtore.

Z. Hubert Perr, Delegacioni i BE-së, u shpreh se BE-ja mirëpret qasjen e biznesit dhe pranimin e rritjes së pagave pasi është në përputhje me procesin e anëtarësimit në BE dhe fokusohet në kohezion. Ky ka të bëjë jo vetëm me përafrimin e *acquis* dhe legjislacionit të tij, por ka në qendër njerëzit duke synuar që të kenë fuqi blerëse të ngjashme. Dhe kjo duhet të fillojë me përafrimin e pagave për të arritur paga të ngjashme dhe të ardhura të ngjashme. Objektivi duhet të jetë që ky hendek të mbyllet gradualisht dhe të mos zgjerohet. Rritja e pagave duhet të shkojë paralelisht me rritjen e produktivitetit dhe Shqipëria duhet të fokusohet në krijimin e një mjedisi favorizues për biznesin. Vendi ka nisur një strategji kombëtare për integrimin evropian dhe është e rëndësishme të identifikohet se ku dëshiron të jetë Shqipëria në të ardhmen dhe si të arrijë atje. BE-ja po punon me qeverinë qendrore dhe vendore dhe njerëzit për të krijuar një mjedis që mundëson biznesin, infrastrukturën, energjinë dhe bujqësinë, dhe ofron mbështetje për bujqësinë, teknologjinë, punësimin e të rinjve, aksesin në financë dhe përbalimin e riskut në aksesin në financim përmes fondeve IPA.

Z. Edvin Premçe, PEA, pasi falenderoi KI dhe Sekretariatit për anketën, nënvizoi:

- Se nevoja për hartimin e një pakete të dedikuar për kompanitë e sektorit, është bërë me kohë dhe nëse do të ishte zbatuar nuk do të ishim sot këtu ku jemi. Kjo nuk bëhet vetëm nga një palë, por kërkon angazhimin e të gjitha strukturave.
- Si sektori me nivelin më të ulët të edukimit dhe më vulnerabël, është i nevojshëm edukimi i punonjësve. Ata shprehen se pagën minimale nuk ma ka rritur biznesi, por qeveria. Edukimi i tyre është i domosdoshëm për të arritur edhe në rritjen e produktivitetit dhe mbështetjen në investimet më makineri dhe promovimin. Kemi një Agjenci (AIDA) që nuk e dimë ku është.
- Biznesi ka shumë nevojë për likuiditet sa që iu drejtohet institucioneve financiare me 15% interes duke përthithur rreth 1 mln Euro. Donatorët i orientojnë bizneset tek institucionet financiare por mbështetja e tyre nuk është e plotë, sepse nuk vlerësojnë faktin që interesat e kredive janë shumë të larta.
- Kursi i këmbimit. MFE dhe BSH të rishikojnë politikën e kursit të këmbimit. Në vendet e rajonit me kurs fiks, mbrohet ekonomia, tregu dhe eksportuesit.

Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, duke vlerësuar përgatitjen e këtij studimi në një kohë kaq të shkurtër, ngriti çështjet e mëposhtme:

- Diskutimi mbi rritjen e pagës ka filluar prej kohësh dhe nuk e ka gjetur biznesit të papërgatitur. Rritja e pagës minimale është kërkesë e vetë zhvillimit ekonomik dhe sikurse rezultoi edhe nga takimet me bizneset nuk pati ndonjë kundërshtim prej tyre. Propozoi të ketë një reformim total të sistemit të pagave dhe të bëhet transparencë mbi hapat në vijim, pasi rritja e pagës minimale, afekton atë mesatare dhe maksimale si në sektorin publik ashtu edhe në privat. Në vijim, kjo reformë të bëhet në bashkëpunim me biznesin, në tryeza të përbashkëta sikurse u nis diskutimi mbi rritjen e pagës minimale.

- Është e nevojshme *lufta kundër informalitetit*, pasi një pjesë e madhe e biznesit ndoshta kanë patur paga më të larta por të padeklaruara. Rritja e pagave duhet të shoqërohet me një platformë për ta monitoruar atë për të mos patur në vijim informalitet si një plagë që ndeshet çdo ditë.
- *Fondet për mbështetjen e inovacionit dhe investimeve në makineri*, sikurse doli edhe nga studimi dhe sektori fason, *dubet të menaxhohen mirë*. AIDA edhe pse kishte një fond në dispozicion dhe pati një numër të lartë aplikimesh, nuk disbursoi asnjë fond dhe bizneset kanë ngelur pa asnjë përgjigje në lidhje me këtë proces.
- *Politikat e mirëqenies (wellfare)*. Këtu mbetet shumë për të bërë nga biznesi, kjo është e lidhur edhe me politikat fiskale dhe ndoshta ky është një moment për të reflektuar sepse është e provuar që ndërthurja e këtyre politikave me përkrahjen fiskale, ndikojnë në rritjen e produktivitetit.
- *Kodi i Punës duhet riparë*. Duhet të akomodojë punën me kohë të pjesshme dhe *smartworking*, duke ofruar më shumë fleksibilitet.
- *Edukimi i punonjësve* duhet të nxitet nga vetë sipërmarrësit.

Z. Agim Rrapaj, KASH, ngriti çështjet e mëposhtme:

- Çështja e pagës ka 2 vjet që po diskutohet në Këshillin Kombëtar të Punës. Ka patur një dakordësi midis biznesit dhe sindikatave për rritjen e pagave.
- Biznesi percepton se me rritjen e pagës minimale do të ketë një rritje të konsumit e cila do të ndikojë pozitivisht industrinë dhe prodhuesit ushqimore. Shpresohet që kjo të japë efektin e duhur.
- Një vëmendje të posaçme duhet të vihet për sektorin bujqësor dhe ata që punojnë aty të cilët nuk preken nga paga minimale. Duhet një vëmendje më e madhe në sektor edhe në kontekstin e shpopullimit që po na ndodh. Për këtë arsye duhet që edhe në këtë sektor të nxitet formalizimi.
- Për grumbulluesit, të cilët janë një pjesë e rëndësishme e zinxhirit ushqimor, duhet të rishikohet mekanizmi i TVSH-së së zbatuar.
- Shkollat Bujqësore (të cilat janë 5 gjithsej). Nxënësit në vitet e para janë reduktuar dhe kjo do të krijojë një boshllëk të madh në të ardhmen. Duhet angazhim nga sipërmarrja dhe MFE.
- Ka një perceptim pozitiv në lidhje me fondet dhe transparencën e ofruar në kuadër të IPA II të cilat janë përfituar 100%. Ka një ndryshim rrënjësor në përdorimin e këtyre fondeve dhe eficiencën e tyre. Kërkesa ka qenë edhe më e madhe për 3-fishin e fondeve. Pra nga 94 Mln kërkoheshin 249 Mln. Bëri thirrje që IPARD III të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të kapet ritmi i duhur.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se është e drejtë që duhet të organizohen tryeza mbi efektet e kursit të këmbimit për disa sektorë dhe eksportet. Banka e Shqipërisë e ka marrë shumë kohë më parë vendimin në lidhje me kursin e këmbimit. Nëse do të bënim një analizë të treguesve makroekonomikë, nuk do të krahasoheshim as me Maqedoninë e Veriut dhe as me Serbinë. Shqipëria ka patur një performancë shumë më të mirë dhe një nga elementet e kësaj performance ka qenë edhe kursi i lirë i këmbimit. Shprehu mirëkuptimin e saj që pjesa më e madhe e eksportuesve sidomos ata që kanë patur kontrata të lidhura prej kohësh janë prekur nga kursi i këmbimit, por nga ana tjetër problematika duhet parë më globale dhe jo e lidhur me një sektor të caktuar.

Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, u shpreh se

- Kursi i lirë i këmbimit me ligj nuk është atribut i BSH. Kjo e fundit është e ngarkuar vetëm për të ndjekur objektivat që lidhen me ruajtjen e inflacionit. Në këtë kuptim nuk do të ishte normale një ndërhyrje e BSH për të ndryshuar kursin e këmbimit në cilindo drejtim. Dy janë rastet kur BSH është e detyruar të ndërhyjë në kursin e këmbimit: (1) kur kursi i këmbimit bëhet pengesë

për politikën monetare në ruajtjen e inflacionit; (2) kur ka çrregullime të dallueshme në tregjet e këmbimeve valutore. Në opinionin e përgjithshëm duket sikur BSH bën kursin e këmbimit, por kjo është e gabuar. Nga ana tjetër edhe nëse shikoni pozicionin e BSH në lidhje me valutën e huaj, konstatohet se BSH ka qenë në pozicion blerje të valutës duke blerë dhjetra milionë euro.

- Në lidhje më kostot e transaksioneve të kartave të kreditit u shpreh se arsyeja e komisioneve të zbatueshme nuk lidhet më shumë me riskun sesa me faktin që mungon një *switch* kombëtar i operatorëve ndërkombëtarë si VISA, Master Card, American Express. Këto të fundit, kostot e shërbimit i lidhin me numrin e transaksioneve. Në këtë kuptim bankat tregtare e kanë të pamundur të ulin kostot për njësi përse kohë që numri i transaksioneve është i ulët. Vërehet një përparim të numrit të pagesave me karta kredit sidomos gjatë vitit të fundit. 60% e pagesave të tregtisë me pakicë (*retail*) bëhen me karta krediti dhe ky është një zhvillim që BSH e ka mbështetur dhe promovuar me politikën e saj. Rritja e numrit të transaksioneve është një nga kriteret për uljen e kostove të tyre, por zgjidhja më e mirë do të ishte një *switch* kombëtar-*operator vetting* i cili nuk mbart kostot e operatorëve ndërkombëtarë. Këtë rol duhet ta bëjnë bankat tregtare. Nëpërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave, BSH ka udhëzuar vazhdimisht këtë element tek bankat. Bankat tregtare e kanë këtë çështje objekt diskutimi edhe në kuadër të shoqatës, por ende nuk kanë arritur në një emërues të përbashkët nëse duhet të bëhet dhe cila bankë duhet t'a ofrojë. Ka patur diskutime që lidhen me aspekte të konfliktit të interesit midis tyre se cila bankë duhet ta ofrojë dhe për këtë arsye kjo çështje ka mbetur ende pa zgjidhje.
- Në lidhje me rritjen e aksesit në financë të grave, nuk është se ka ndonjë politikë që vetë sistemi financiar të ketë një masë të dedikuar në këtë aspekt, ashtu sikurse nuk ka ndonjë barrierë në lidhje me këtë gjë. Nëse duhet të ketë një politikë të veçantë mbështetje, nuk është BSH që mund ta ofrojë këtë, por sigurisht që mund ta mbështesë atë. BERZH ka një projekt të dedikuar për mbështetjen e sipërmarrëseve gra. Kjo mbështetje mund të jetë fillesë për nxitjen edhe të operatorëve të tjerë.
- Qasja e biznesit për ta parë të lidhur rritjen e pagës me produktivitetin është mbresëlënëse, si një plagë e ekonomisë shqiptare. Ekonomia globale është sot në fazën e 4 të mënyrës së prodhimit, ajo që quhet Ekonomia e Dijes. Kjo e fundit ka 2 faktorë të rëndësishëm: teknologjinë dhe kapitalin human (njohuritë). Edhe ekonomia në vend nuk mund t'i shmanget këtij trendi. Ka ardhur koha që biznesi të mendojë për trajnimin e stafit dhe për nxitje të aksesit në financë nga bizneset që priren drejt inovacionit dhe teknologjisë. Një program i tillë nuk ekziston, dhe ndoshta ky moment mund të shërbejë për ta evidentuar këtë fushë për mbështetje, edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Një program garancie nga një aktor ndërkombëtar i jashtëm për të mitiguar riskun e financimit të subjekteve të reja në fushën e inovacionit dhe teknologjisë mund të ishte efektiv. Këto biznese nuk kanë ende një vizion afatgjatë dhe financimi i projekteve të këtyre bizneseve të reja është i vështirë. Këtu duhet të vendoset fokusi dhe kanalizimi i mbështetjes financiare në funksion të ekonomisë shqiptare.
- Produktiviteti duhet të jetë çelësi i ekonomisë. Përfshirja në zinxhirët globalë shoqërohet me përfitim të dijeve dhe integritit, dhe përvoja ndërkombëtare duhet të ndahet edhe në këtë tryezë.
- Referuar krahasimit të z. Shkodra me Maqedoninë, u shpreh se Maqedonia merr Shqipërinë si shembull të situatës së mirë makroekonomike sepse e ka 18% inflacionin duke mbajtur një kurs fiks ndaj Euros dhe duke mos ushtruar funksionin rregullues të politikës monetare. Kjo është edhe arsyeja që disa vende nuk dëshirojnë të hyjnë në Eurozonë sepse duan ta kenë politikën monetare funksion të tyre sa më gjatë. Gjithsesi, BSH nuk ka luajtur një rol pasiv, dhe ka hartuar një raport të veçantë në lidhje me rënien e kursit të këmbimit, i cili mund të ndahet edhe me anëtarët e KI.

Zv/Ministria Olta Manjani, MFE, u shpreh se duke qenë se një nga çështjet kryesore që u ngritën në këtë mbledhje ishte aftësimi i forcës punëtore, shpjegoi shkurtimisht planin e veprimit i

cili do të ndahet në dy drejtime kryesore: i) Motivimi i punonjësve, i cili sikurse evidentuar edhe në anketimin e Sekretariatit, rritja e pagës ndikon në 50% të motivimit, ii) Produktiviteti që rritet përmes investimeve në inovacion e teknologji dhe forcimin e dijeve në këtë drejtim.

Tek e para është qeveria ajo që ka punuar për të rritur motivimin, sigurisht që këtu edhe biznesi ka një rol shumë të vecantë meqenëse duhet të investojë në aftësimin e forcës punëtore dhe në teknologji. Pra biznesi duhet ta çojë përpara këtë. Referuar aftësimin të forcës punëtore, për herë të parë në dhjetor 2022 janë përfshirë në lëvimin e formimit profesional edhe operatorët privatë, si p.sh. koduesit, duke subvencionuar 50-100% të trajnimit të forcës punëtore dhe kjo pritet të shtrihet përtej sektorit TIK. U nis me këtë sektor duke qenë një nga më të rëndësishmit, si sektor që po ecën me shumë shpejtësi, një sektor gjithpërfshirës i cili ka pasur edhe një hendek të madh.

Është hera e parë që në formimin profesional hyjnë operatorët privatë dhe subvencionohen me metodën përmes *voucher* e cila ka dhënë rezultat mjaft pozitiv në vende të tjera. Pra është hapur loja dhe konkurrenca në drejtim të formimit të forcës punëtore duke përfshirë përtej shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional edhe operatorët privatë dhe duke shtyrë sektorin publik të ecë përpara.

Mekanizma të tjerë përmes të cilëve përfshihet sektori privat në forcimin e aftësimin të forcës punëtore apo edhe në të kuptuarit e nevojave të tregut, janë (a) Komitetet sektoriale që marrin feedback të drejtpërdrejtë nga tregu duke i përkthyer në kurrikula të përshatshme ndaj nevojave të tregut, (b) një element mjaft i rëndësishëm janë edhe pjesëmarrja e bizneseve në bordet e shkollave profesionale si kryetarë të tyre, çfarë garanton *feedback* të drejtpërdrejt të nevojave të tregut.

Çështje e dytë, janë pagesat e kontributeve shoqërore, duke iu referuar edhe praktikave nëpër botë, efektet e kontributeve shëndetësore dhe shoqërore paguhen mbi një pagë minimale dhe sigurisht me rritjen e saj rriten edhe kontributet duke mos qenë një taksë por kontribut për pensionet, dhe kjo lidhet edhe me edukimin e forcës punëtore. Arsyet pse pensionet janë të ulëta dhe duhen rishikuar. Kjo lidhet me pagën e ulët minimale ndër vite dhe kjo ndikon që duke u rritur paga minimale edhe pensionet do rriten.

Elementi i tretë që lidhet me përfshirjen e grave në biznes, janë programet e nxitjes së punësimit me 6 programe që subvencionojnë pagën apo kontributet për disa muaj. Gjatë vitit të fundit kanë qenë rreth 1.248 biznese përfituese nga këto fonde dhe 4.443 individë. Subvencionimi që jepet për pagesat e kopshteve dhe çerdheve për nënat e reja me fëmijë dhe subvencionimi i transportit si për burra dhe gratë nëse vendi i punës është mbi 2 km larg nga vendbanimi.

Zv/Ministër Endrit Yzeiraj, MFE, u shpreh se në Shqipëri po flitet për modelin e zhvillimit ekonomik aktualisht dhe sa hendek kemi mbyllur që nga 1990 me vendet e BE duke u nisur nga baza më e ulët. Në baza rritje, Shqipëria dhe Polonia kanë patur rritjen më të madhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, por kryesisht bazuar në një model të përqendruar në turizëm, bujqësi, lëndë minerare. Tani kemi nevojë të bëjmë një kapërcim dhe rritje cilësore dhe politika e rritjes së pagës është një nga shtysat që çon në këtë drejtim, por nuk është e vetmja. E dimë që kemi nevojë të inovohemi e teknologjizohemi dhe kjo bëhet falë aksesit në financë, ndaj kjo është një nga politikat ku do fokusohemi në vitet në vijim. Kemi në proces një garanci sovranë për manifakturën por detajet do zbardhen pak më vonë dhe ka një sërë programesh nga BE me fonde që ndoshta nuk përfshihen shumë por do ridrejtohen dhe për të parë aspekte se ku sektori financiar do mund të lehtësojë aksesin.

Për të rritur produktivitetin kemi nevojë për ekonominë e shkallës pra shumë njerëz e shumë kapital dhe Shqipëria nuk ka shumë, por biznes *outsourcing* është dicka që mund ta bëjmë edhe më shumë pasi të rinjtë shqiptarë integrohen më shpejt se shoqëritë e tjera, ndaj do fokusohemi në këtë drejtim. Referuar politikave industriale, kemi disa ide që do diskutohen në vijim me ju.

Z. Bledar Mankollari, DIHA, u shpreh se parimisht asnjë biznes nuk është pro rritjes së rrogës në tërësi duke e parë në aspektin gjeografik. Për Tiranën ndoshta rritja e pagës minimale është e vonuar, ndërsa për rrethet ka një problem sepse kanë tjetër shpejtësi ekonomie me Tiranën dhe elementi gjeografik është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt, ndaj ndoshta do ishte më mirë që referuar raportit të sjellë në tryezë nga Sekretariat, të kishte detaje mbi efektet p.sh. sa të ardhura shtesë do paguhet, çfarë u bë, sa paguajnë bizneset më shumë, çfarë pritet konkretisht përmes rritjes sepse do ishte interesante për sektorin privat.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, iu përgjigj në mënyrë të përmbledhur komenteve të ngritura:

- Ndarja gjeografike e pagave është një çështje që u mendua gjatë përpara se të përcaktohej paga minimale pasi është e rëndësishme të kuptohet produktiviteti dhe potenciali i kompanive në Tiranë dhe nëpër rrethe, por nga perspektiva ligjore, kjo është e pamundur për momentin. Nëse ka argumente të mjaftueshme dhe mbështetje të biznesit, kjo mund të shihet në të ardhmen.
- Sa i takon transparencës mbi të ardhurave shtesë nga kontributet shoqërore, analiza mund të bëhet lehtësisht duke iu referuar të dhënave të dhjetor 2022 dhe të llogariten të ardhurat e pritshme nga prill 2023. Nëse do të ketë ndryshime në të ardhmen, analizat do të bëhen më të komplikuar sepse do të duhet të konsiderohen rritja e numrit të punonjësve dhe ndryshimi i strukturës së punonjësve që do shkaktohet nga rritja e pagës minimale. Nuk është e sigurt nëse ky informacion do të ketë interes për publikun pasi skema e pensioneve është deficiente dhe të gjithë duhet të kuptojnë rëndësinë e pensionit, por siguroi se analizat do të jenë në dispozicion.
- Në lidhje me elementët që prekin pagat, produktivitetin dhe aftësitë, Ministria u shpreh se është e rëndësishme që të punohet në drejtim të aftësimin për punët e reja dhe teknologjinë, si dhe mbi nevojën që ka tregu shqiptar bazuar në strukturën e tij. U përmendën strukturat bujqësore dhe rëndësia e sektorit bujqësor për ekonominë. Nëse pagat në sektorin bujqësor do jenë të ulëta, interesimi për të formuar njerëz në këtë drejtim do jetë i ulët.
- Plani kombëtar i punës dhe pagave është shumë i rëndësishëm për të realizuar potencialet që ka nevojë ekonomia jonë. Edhe pse ne mund të përdorim aftësitë dixhitale, teknologjia ndryshon shpejt në harkun e 6 muajve, kështu që është e rëndësishme që të trajnohen njerëzit e aftë për të trajnuar.
- Ndoshta është koha që të rishikojmë disa elemente të Kodit të Punës dhe të diskutohet në Këshillin Kombëtar të Punës. Ministria inkurajoi bizneset të përfshihen në grupe më të vogla dhe të diskutojnë për rritjen e pagës minimale. Qeveria do të hartojë politikën, por shprehu dëshirën e elaborimit të një politike për sektorin privat në lidhje me burimet njerëzore, meqenëse u diskutua që punëmarrësit kërkojnë një pagë të lartë që në fillim, por është e rëndësishme të ndërtohet një trajektore e qartë dhe një strukturë pagash bazuar në aftësi dhe përvojë.
- Nëse nevojiten rregullime të Kodit të Punës për këtë çështje, duhet t'i konsiderojmë ato, por duhet të jemi të kujdesshëm sepse sektori privat tenton të shfrytëzojë legjislacionin në drejtim të informalitetit. Ne nuk duam të imponojmë politika qeveritare që mund të perceptohen sikur prishin klimën e biznesit, por kërkojmë që të hartohet dhe komunikohet një politikë e mirëfilltë për burimet njerëzore. Ministria propozoi krijimin e një grupi pune nga sektori privat që të sjellë propozime paralelisht.
- Në lidhje me konkurrencën me jashtë, nuk është diçka që mund të zgjidhet lehtësisht, por mund të lehtësohen kushtet për punën në distancë, që do të na bënte më konkurrues ndaj punonjësve të huaj që vijnë nga jashtë. Kjo mund të realizohet përmes politikave të brendshme të kompanive.
- Ministria shprehu mirëkuptimin për shqetësimet e biznesit dhe u shpreh se është e vërtetë që politikat e taksave dhe të subvencionimit mund të kenë efekte të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Sipas eksperiencës, reduktimi i taksave mund të jetë efektiv në rritjen e aktivitetit

ekonomik dhe në krijimin e vendeve të reja të punës në disa sektorë të veçantë, por nuk është gjithmonë zgjidhja e duhur për të gjitha sektorët dhe në të gjitha kohërat. U shpreh në favor të mbështetjes së sektorit të manufakturës ndaj duhet të ridiskutohet nëse jemi në të njëjtat kushte me ato të para një viti. Në përgjithësi, politikat fiskale duhet të jenë të drejtpërdrejta, transparente dhe të rregullta për të siguruar një klimë të ndershme biznesi dhe për të rritur besimin e investitorëve në vendin tonë.

- Aksesimi në financë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve dhe ekonomisë në përgjithësi. Banka Botërore dhe BE kanë shumë programe për mbështetjen e bizneseve, sidomos atyre të grave, të rinjve dhe në zonat rurale. Një prej programeve më të njohura është “Garancia Rinore”, e cili ka pasur sukses në disa vende të BE-së dhe mund të përdoret si model për vendet e tjera. Kjo garanci ofron kredi të ulëta për të rinjtë që kanë vështirësi në qasje në financë dhe do të ndihmojë ata që kanë ide të mira biznesi të fillojnë dhe të zhvillohen. Në të njëjtën kohë, kjo garanci do të rrisë edhe punësimin dhe rritjen ekonomike në zonat rurale dhe në qytete të vogla. Prandaj, mbështetja e bizneseve të të rinjve dhe grave është e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së një vendi.
- Studimet krahasuese me vendet e rajonit janë të rëndësishme për të vlerësuar se si ndodh rritja ekonomike dhe se si funksionon sistemi fiskal në një vend në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në këtë mënyrë mund të identifikohen si avantazhet, ashtu edhe sfidat në fushën e politikës fiskale. Zakonisht kur krahasohemi me vendet e tjera përmenden vetëm ato raste kur kemi taksa më të larta, jo ato ku jemi me taksa më të ulëta. Një studimi krahasues me vendet e rajonit mund të ishte i dobishëm.
- Institucionet mikrofinanciare janë ato që ofrojnë norma të larta interesi në krahasim me bankat tradicionale, për shkak të kostos së lartë të administrimit të kredive të vogla dhe rreziqeve të larta që i shoqërojnë ato. Megjithatë, institucionet mikrofinanciare kanë vlerë të madhe në zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme dhe në ndihmën e njerëzve që kanë nevojë për kredi.
- Në lidhje me shpërblimet dhe dietat, diskutimi në këtë drejtim mund të jetë i dobishëm për të gjetur zgjidhje që janë të drejta dhe të ndershme për të gjithë. Ministria shprehu gatishmërinë e qeverisë për të ndihmuar në dixhitalizim jo me grante, por me garanci për sektorë që kanë potencial e nevojë për mbështetje. Mund të ofrohet mbështetje në këtë drejtim dhe për ndarjen e kostos së trajnimit për punonjësit në mënyrë që të mbahen sa më gjatë në punë. Propozoi që të ngrihen grupe pune që të menaxhohen nga dy zv/ministrat, një pjesë nga znj. Manjani dhe një pjesë nga z. Yzeiraj. Së shpejti do jetë mbledhja e Këshilli Kombëtar të Punës dhe do diskutohen këto çështje që u ngritën këtu ndërsa për produktivitetin dhe taksat dhe produkte të caktuara do ndiqen drejtpërdrejtë nga z. Yzeiraj.

Komente shtesë:

- Shoqata e Biznesit të Diasporës ka sugjeruar përmirësimin e sistemit të tatimeve në lidhje me pagat bruto dhe neto, dhe do të dërgojnë një propozim konkret për të lehtësuar dhe përmirësuar sistemin. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndryshojë faqen e tatimeve për të përfshirë një algoritëm që do t'i lejojë individëve të shënojnë numrin e ditëve që punojnë dhe të llogarisin pagën e tyre neto/bruto.
- Shoqata e Turizmit ka sugjeruar që të hiqet programi i maturës shtetërore në shkollat profesionale për t'i bërë ato më atraktive dhe të ulët numri i nxënësve që largohen nga ky lloj arsimimi. Ministria konfirmoi se nevojitet më shumë arsim profesional dhe po diskutohet me Ministrinë e Arsimit për të bërë ndryshime dhe për t'i bërë këto shkolla më tërheqëse.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministria Ibrahimaj falenderoi pjesëmarrësit për kontributin dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Financave dhe Ekonomisë
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Pranvera Selgjakaj, Drejtore Ekzekutive, Këshilli Ekonomik Kombëtar, deleguar nga znj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Znj. Antoneta Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
4. Z. Arben Shkodra, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
5. Z. Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv, AmCham Albania
6. Znj. Elisabeta Katiaj, Drejtore Ekzekutive, deleguar nga z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
7. Z. Zak Topuzi, Shoqata e Turizmit/Hotel Mondial (*ad-hoc*)
8. Z. Edvin Prençe, Kryetar, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA) (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
2. Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së

Nuk morën pjesë:

1. Z. Sokol Nano, CEO, AIDA
2. Z. Emanuel Salinas, Menaxheri i Zyrës së Banka Botërore në Tiranë
3. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC
4. Z. Bilal Kara, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO)

Të ftuar të veçantë:

1. Znj. Olta Manjani, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Të ftuar të tjerë:

Ish anëtarë të biznesit në KI

1. Z. Bledar Mankollari, Drejtor Ekzekutiv, Dhoma Gjermane e Tregtisë (DIHA)
2. Znj. Odeta Melo, Kryetare e Komitetit të Kapitalit Njerëzor, FIAA

Përfaqësues të tjerë

3. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH
4. Z. Denald Tafani, Kryetar, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
5. Znj. Erifili Berberi, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
6. Z. Bashkim Sykja, Drejtor Kabineti, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë

7. Znj. Flutura Xhabija, Presidente, Shoqata e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare (SHGPAZ)
8. Znj. Tefta Demeti, Shoqata e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare (SHGPAZ)
9. Znj. Marlinda Zotaj, Drejtore Ekzekutive, Advantage Austria
10. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, Delegacioni i BE-së
11. Znj. Esmeralda Shehaj, Eksperte për Çështjet Gjinore, BERZH